



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANE SH.A.**  
**DREJTORIA E PROKURIMEVE**  
**SEKTORI I INVESTIMEVE DHE PROJEKTEVE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_/\_\_\_\_/2019

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

**Për:** Operatorin Ekonomik “SENKA” shpk me administrator Zj. Donika Senka, me numër NIPT-i J94808405Q me adresë: Lushnje, Xhevdet Nepravishta.

**Procedura e prokurimit:** Kërkesë për propozim

**Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër:** “Ndërtim rrjet shpërndarës ujësjellësi në lagjen e Malësorëve”

**Numri i referencës së procedurës/lotit:** REF-23278-05-22-2019

**Fondi limit:** 9.270.072 (nëntë milion e dyqind e shtatëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

**Kohëzgjatja:** 1 (një) muaj duke nisur nga data e dorëzimit të sheshit të punimeve.

**Data e zhvillimit të tenderit është:** 03.06.2019 Ora: 09:00

**Buletini i Njoftimeve Publike:** Nr.21 të dates 27.05.2019

Njoftojmë se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “**Desaret Company**” shpk. *NIPT-it* K01816001J

Vlera: 9.000.863 (nëntë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

2. Operatori Ekonomik “**HTM**” sh.p.k *NIPT-i* K97006004D

Vlera: 9.160.799 (nëntë milion e njëqind e gjashtëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh

3. Operatori Ekonomik “**SENKA**” shpk *NIPT-i* J94808405Q

Vlera: 8.625.645 (tetë milion e e gjashtëqind e njëzetë e pesë mijë e gjashtëqind e dyzetë e pesë) lekë pa TVSH.

## **Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:**

### **1. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik “Desaret Company” shpk, me vlerë të ofertës 9.000.863 (nëntë milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

**Së PARI:** Autoriteti kontraktor ka kërkuar në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit / Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar si më poshtë cituar:

#### **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

*1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:*

- a. Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*
- c. Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*
- ç. Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- dh. Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*
- e. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*
- f. Deklarate mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*

Referuar kriterëve të kërkuar në DST Komisioni I Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori ekonomik “**Desaret Company**” shpk nuk ka arritur të paraqesë dokumentacionin e kërkuar në DST. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik KVO konstaton se operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion(shtojcat e mesiperme) për të dëshmuar plotësimin e kriterit të kërkuar në DST.

Evidentimi i mungesës së dokumentacionit të kërkuar në DST KVO konkludon se operatori nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe legjislacionit në fuqi dhe për rrjedhojë nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Ne rregullat e prokurimit publik theksohet se , operatorët janë të detyruar të përgatitin ofertat dhe **paraqesin të plote të gjithë dokumentacionin e kërkuar në DT .**

Moplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vetëm përben shkak për skualifikim .

Në shtojcën 11 shprehimisht parashikohet se.... **Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

**Së DYTË:** *Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit Kriteret e Veçanta të Kualifikimit / Kapaciteti teknik ka kërkuar si më poshtë cituar:*

g. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri

Për plotësimin e kriterit për shlyerjen e energjisë elektrike, operatori ekonomik **“Desaret Company” shpk** ka paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm në portalin elektronik të APP-së për këtë procedurë prokurimi:

“Vërtetim debie” nr. 2352 prot, date 19.03.2019 lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, në emër të kërkuarit “Desaret Company” shpk ku evidentohet që: “... nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën me nr. TR1F040112246344 me rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 18.03.2019 pa përfshirë faturën koherente të muajit Shkurt 2019.

Referuar Nenit 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.

Vërtetimi i Debisë i paraqitur në sistemin elektronik nga Operatori ekonomik nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për periudhën më të fundit para hapjes së ofertave që tashmë ishte maturuar për procedurën e prokurimit konkretisht muajin Prill 2019.

Nisur nga sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se Operatori ekonomik “nuk plotëson Kriteret e Veçanta për Kualifikim pika 1 gërma “d” të vendosur në DST, c’ka bie në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se ”Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë.”

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se dokumentacioni i paraqitur për përmbushjen e këtij kriteri është i paplotë për rrjedhojë i pavlefshëm.

**Së TRETË:** *Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit Kriteret e Veçanta të Kualifikimit / Kapaciteti teknik ka kërkuar si më poshtë cituar*

*5.Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar si staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit stafi inxhinierik si më poshtë:*

- 1(një) Inxhinier Ndërtimi
- 1(një) Inxhinier Hidroteknik
- 1(një) Inxhinier Elektrik

*8. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda nga te cilet një automakiniste dhe një eskavatoriste. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per tre muajt e fundit.*

Për zbatimin e punimeve të cilët ka marrë përsipër Operatori ekonomik “Desaret Company” shpk ka paraqitur punonjësit e mëposhtëm:

- 1.Ing. Ndertimi punonjës in E.B,

Ndërkohë, ky Operator nuk ka paraqitur inxhinier Hidroteknik dhe inxhinier elektrik, me qëllim realizimin e kontratës, si dhe nuk ka paraqitur asnjë punonjës manovratorë të mjeteve të rënda nga të cilët duhet të paraqiste një automakinist dhe një eskavatorist.

OE” “Desaret Company” shpk nuk zotëron kapacitet të mjaftueshëm teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e Veçanta për Kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe Profesional, pika 4/i, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se:

*Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....*

*b)Aftësia teknike; Operatorët ekonomik vërtetojnë se i zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike profesionale kapacitetet organizative, makineritë, paisjet dhe asetet e tjera fizike, aftësitë organizative,.reputacionin besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën.*

Në këtë rast K.V.O është e detyruar të zbatojë nenin 55/2 të ligjit nr.9643,datë 20.11.2006”Për prokurimin Publik” në të cilën citohet se ...*Autoriteti Kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme për të përcaktuar ofertën fituese në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit.*

Pra, përfundimisht K.V.O gjykon se duhet të vlerësojë përmbushjen e çdo kriteri për kualifikim që gjendet në DT dhe operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatitin ofertat dhe të paraqesin të plotë dokumentacionin e kërkuar në DT.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII,Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

## **2. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “HTM” sh.p.k. me vlerë të ofertës 9.160.799**

(nëntë milion e njëqind e gjashtëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për

“Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

- *AK në Dokumentat Standarte të Tenderit në Kriteret e Veçanta ka kërkuar për realizimin e kontratës si më poshtë:*

**g. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.**

Për plotësimin e kriterit për shlyerjen e energjisë elektrike, shoqëria “HTM” sh.p.k ka paraqitur dokumentacionin e mëposhtëm në portalin elektronik të APP-së për këtë procedurë prokurimi:

*“Vërtetim debie” nr. 1909 prot, datë 02.05.2019, lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, në emër të kërkuesit “HTM” sh.p.k, ku evidentohet që: “... nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën me Kod SH2A0100120355919... rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 02.05.2019, pa përfshirë faturën koherente të muajit Prill 2019”.*

- Refruar Neni 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me VKM Nr. 109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, **jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.**
- Vërtetimi i Debisë i paraqitur në sistemin elektronik nga Operatori ekonomik nuk vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për periudhën më të fundit para hapjes së ofertave që tashmë ishte maturuar për procedurën e prokurimit konkretisht muajin Prill 2019 ( i cili duhej të paguhej nga operatori ekonomik deri më datën 31.05.2019, këtu vlen të theksohet se ofertat ekonomike janë hapur më datën 03.06.2019).
- Nisur nga sa më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se Operatori ekonomik “HTM” shpk, nuk plotëson Kriteret e Veçanta për Kualifikim pika 1 gërma “g” të vendosur në DST, c’ka bie në kundërshtim me VKM-në Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu III, Seksioni II, Neni 26, pika 7 gërma “c” ku ndër të tjera citohet se **”Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankiminë gjykatë.”**
- *Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik ka kërkuar si më poshtë:*

5.Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit stafi inxhinierik si më poshtë:

- 1(një) Inxhinier Ndërtimi
- 1(një) Inxhinier Hidroteknik
- 1(një) Inxhinier Elektrik

Operatori ekonomik ka paraqitur në përmbushje të këtij kriteri si më poshtë:

- J.D Inxhinier Ndërtimi
- S.B Inxhinier Elektrik

Në përmbushje të kriterit të mësipërm shoqëria nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për të provuar që ka të punësuar në staf teknik – 1(një) Inxhinier Hidroteknik

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti pika 5, është i paplotë, **për rrjedhojë i pavlefshëm.**

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatorëve Ekonomik lidhur me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti pika 8, është i paplotë, **për rrjedhojë i pavlefshëm.**

- *Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik ka kërkuar si më poshtë:*

7.Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit të pakten 6 (gjashtë) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga keta te jene te pakten:

- Grupi I-2 (dy) punonjës
- Grupi II-2(dy) punonjës
- Grupi III- 1(një) punonjës
- Grupi IV- 1(një) punonjës
- (Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmite perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik, kontratat e punes te vlefshme)

Nga shqyrtimi që Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i bëri dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të app-së rezulton se operatori ekonomik “HTM Sh.p.k **nuk ka paraqitur asnjë punonjës** të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatorëve Ekonomik lidhur me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti pika 7, është i paplotë, **për rrjedhojë i pavlefshëm.**

- *Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik ka kërkuar si më poshtë:*

8.Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda nga te cilet një automakiniste dhe një eskavatoriste. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per tre muajt e fundit

Nga shqyrtimi që Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i bëri dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të app-së rezulton se operatori ekonomik “HTM Sh.p.k **nuk ka paraqitur asnjë punonjës manovrator të paisur me dëshmi drejtimi të vlefshme për automakinist dhe eskavatorist.**

Pra sa më sipër Shoqëria “HTM” sh.p.k nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket **personelit të nevojshëm** për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i

ndryshuar ku përcaktohet se: Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

- Autoriteti kontraktor në Dokumentat Standarte të Tenderit tek Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik ka kërkuar si më poshtë:

14. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pike pesë) ton dhe maksimumi 5(pesë) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m3	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 12(dymbëdhjetë) ton dhe maksimumi 17(shtatëmbëdhjetë) ton për secilin kamion	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 cope	Pronësi ose me qera
Pompë uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	3 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	1 cope	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 cope	Pronësi ose me qera
Motogjenerator	1 cope	Pronësi ose me qera
Makine per ngjitje tubash PE	1 cope	Pronësi ose me qera
Saldatrice	1 cope	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 25 copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 3 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 3 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 2 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 4 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqerohet me kontratën perkatëse të

qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.
- c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- f) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë te deklaruara ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor; UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).

Operatori Ekonomik “HTM” Sh.p.k. në përmbushje të kriterit të mësipërm kanë deklaruar në shtojcën nr.10 se disponojnë mjetet e mëposhtëme:

*Kamion me targa AA023PM me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 4.3 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton)*  
*Autovinç me targa AA021PP me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 0.9 Ton .*

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion tre kamion **kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 3.5 ton dhe maximum 5 ton secili kamion** për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri nga tre kamiona ka paraqitur vetëm një kamion me tonazhin e kërkuar nga AK.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatorëve Ekonomik lidhur me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti pika 14, është i paplotë, **për rrjedhojë i pavlefshëm.**

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion një kamion **kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 12 ton dhe maximum 17 ton secili kamion** për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri nuk ka paraqitur asnjë kamion me tonazhin e kërkuar nga AK. Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatorëve Ekonomik lidhur me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti pika 14, është i paplotë, **për rrjedhojë i pavlefshëm.**

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion tre kamionçinë **kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 1.5 ton dhe maximum 2 ton secili kamionçinë** për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri nuk ka paraqitur asnjë kamionçinë me tonazhin e kërkuar nga AK.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatorëve Ekonomik lidhur me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti pika 14, është i paplotë, **për rrjedhojë i pavlefshëm.**

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion një Fadrome me goma, një Eskavator me goma 0.25 m3, një Autobot uji, një Autobetoniere, për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në



përbushje të këtij kriteri nuk ka paraqitur asnjë nga makinerite e sipër permendura .

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatorëve Ekonomik lidhur me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti pika 14, është i paplotë, **për rrjedhojë i pavlefshëm.**

Pra sa më sipër Shoqëria “HTM” sh.p.k nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket mjeteve për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....*

Gjithashtu sqarojme se nuk jemi në kushtet e nenit 53, pika 1 e LPP në të cilin përcaktohet se *“Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cënuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme”,* pasi sqarimet mund të

kërkohen vetëm në rast se autoriteti kontraktor e shikon të nevojshme dhe arsyeshme për vërtetësinë e dokumentacionit dhe jo në rastin konkret.

Në këtë rast K.V.O është e detyruar të zbatojë nenin 55 /2 të ligjit nr.9643,datë 20.11.2006”Për prokurimin Publik” në të cilën citohet se ...Autoriteti Kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme për të përcaktuar ofertën fituese në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Pra,përfundimisht K.V.O gjykon se duhet të vlerësojë përbushjen e çdo kriteri për kualifikim që gjendet në DT dhe operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatitin ofertat dhe të paraqesin të plotë dokumentacionin e kërkuar në DT.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII,Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “SENKA” shpk, me administrator Zj. Donika Senka, me numër NIPT-i J94808405Q me adresë: Lushnje, Xhevdet Nepravishta, me vlerë prej **8.625.645 (tetë milion e e gjashtëqind e njëzetë e pesë mijë e gjashtëqind e dyzetë e pesë) lekë pa TVSH.** se është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a me adresë Rruga Kavajes Nr.133, Njesia administrative Nr.6,Kodi Postar 1027, me nr Tel: 00 355 42240978, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 06.06.2019

**Ankesa:** Nuk ka patur.

## **TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**REDI MOLLA**